



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesave për rishqyrtim të OE "Studio Hapsira Sh.P.K." të datës 06.03.2024, të OE "Infra Plus Sh.P.K." të datës 05.03.2024, të OE "Vizion Project" të dt. 06.03.2024, të OE "Geo Group Sh.P.K." të datës 05.03.2024 si dhe të "Arhiko.Ing Sh.P.K. të datës 05.03.2024, kundër njoftimit mbi vendimin të datës 01.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e OE "Florije Jahaj" të datës 03.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2024.
- II. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e OE "Arhiko.ing Sh.P.K." të datës 03.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2024.
- III. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e OE "Infra-Plus Sh.P.K." të dt. 03.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2024.
- IV. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e OE "Geo Group Sh.P.K." të datës 04.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2024.
- V. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e OE "Studio Hapsira Sh.P.K. të datës 04.12.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2024.
- VI. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- VII. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ndaj njoftimit mbi vendimin e datës 29.11.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, brenda afatit ligjor janë pranuar kërkesat për rishqyrtim të OE "Florie Jahaj" të datës 03.12.2024, të OE "Arhiko.ing Sh.P.K." të datës 03.12.2024, të OE "Infra-Plus Sh.P.K." të dt. 03.12.2024, të OE "Geo Group Sh.P.K." të datës 04.12.2024 si dhe të OE "Studio Hapsira" të datës 04.12.2024.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtruesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtruar brenda afatit nga personat e autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar ato. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të këtyre kërkesave.

1. Pretendimet e OE "Florijs Jahaj BI" janë si vijon

Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit tonë, ku është cekur nga AK-ja se tek përshkrimi i çmimeve dhe paramasës shumat e nën pozicioneve nuk përputhen me shumat totale në pozicione, ju sqarojmë se ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar.

Kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se tek paramasa ne exel e cila është përpiluar nga autoriteti kontraktues, figuron që tek kolona e vendosjes se çmimeve është zbrazët dhe kjo kolonë është hapësira e vetme ku edhe lejohet OE vendosja e çmimeve dhe atë vetëm 2 numra pas presjes dhjetore. Pra struktura e paramasës është respektuar duke vendosur çmime vetëm në kolonën e lejuar me 2 numra pas presjes dhjetore.

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

Juve në ofertën e juaj, tek përshkrimi i çmimeve dhe paramasës shumat e nënpozicioneve nuk përputhen me shumat totale në pozicione si në vijim:

Shuma e nënpozicioneve A1 deri A5 të pozicionit A në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit A (shuma e nënpozicioneve është 0.14 euro ndërsa për pozicionin A është ofertuar me 0.13 euro).

Shuma e nënpozicioneve B1 deri B12 të pozicionit B në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit B (shuma e nënpozicioneve është 0.12 euro ndërsa për pozicionin B është ofertuar me 0.10 euro).

Shuma e nënpozicioneve C1 deri C3 të pozicionit C në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit C (shuma e nënpozicioneve është 0.03 euro ndërsa për pozicionin C është ofertuar me 0.04 euro).

Shuma e nënpozicioneve E1 deri E6 të pozicionit E në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit E (shuma e nënpozicioneve është 0.06 euro ndërsa për pozicionin E është ofertuar me 0.04 euro).

Ju si OE-ik nuk keni vazhduar sigurimin e tenderit konform kërkesave të FDT-se neni (13.2) nga data 21.09.2024.

Fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk i konteston fare arsyet eliminuese lidhur me paramasën. Po ashtu nuk kundërshton faktin që mungon sigurimi i tenderit. Pra nuk është aspak kontestues që oferta e parashtruesi është e papërgjegjshme. Përndryshe AK ka konfirmuar me bindje të plotë se të gjitha arsyet eliminuese të konstatuara nga komisioni vlerësues janë të sakta në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Florije Jahaj BI" janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

2. Pretendimet e OE "Arhiko.ing Sh.P.K." janë si vijon:

- Ndërsa që nga data 18.04.2024- nuk kemi pranuar asnjë kërkesë nga ana e AK për vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe validitetit të ofertës.
- Me datën 29.11.2024 kemi pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktues ku në këtë vendim AK kundërligjshëm ka vazhduar procedurën e tenderimit, dhe ka eliminuar kompaninë tonë me pretendimin që nuk kemi vazhduar validitetin e sigurimit dhe ofertës, ndërsa që nga data

Parashtruesi po ashtu pretendon se edhe tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

Juve në ofertën e juaj, tek përshkrimi i çmimeve dhe paramasës shumëat e nënpozicioneve nuk përputhen me shumëat totale në pozicione si në vijim:

Shuma e nënpozicioneve A1 deri A5 të pozicionit A në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit A (shuma e nënpozicioneve është 0.22 euro ndërsa për pozicionin A është ofertuar me 0.21 euro).

Shuma e nënpozicioneve D1 deri D9 të pozicionit D në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit D (shuma e nënpozicioneve është 0.35 euro ndërsa për pozicionin D është ofertuar me 0.33 euro).

Shuma e nënpozicioneve E1 deri E6 të pozicionit E në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit E (shuma e nënpozicioneve është 0.06 euro ndërsa për pozicionin E është ofertuar me 0.08 euro).

Shuma e nënpozicioneve F1 deri F5 të pozicionit F në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit F (shuma e nënpozicioneve është 0.05 euro ndërsa për pozicionin F është ofertuar me 0.04 euro).

Ju si GOE-ik nuk keni vazhduar sigurimin e tenderit konform kërkesave të FDT-se neni (13.2) nga data 17.09.2024

Fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk i konteston fare arsyet eliminuese lidhur me paramasën. Po ashtu nuk kundërshton faktin që mungon sigurimi i tenderit. Pra nuk është aspak kontestues që oferta e parashtruesi është e papërgjegjshme. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me pretendimin e tij drejtuar

kundër tenderuesit të rekomanduar pasi që nuk mund të dëshmoj asnjë interes material në rast të rivlerësimit përkitazi me këtë pretendim. Megjithatë AK konfirmon se oferta e tenderuesit të rekomanduar është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit dhe të gjitha të gjeturat e komisionit vlerësues janë të sakta në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Arhiko-ing Sh.P.K." janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

3. Pretendimet e OE "Infra-Plus Sh.P.K." janë formuluar si vijon:

AK i referohet ne vendim se oferta financiare tek përshkrimi i çmimeve dhe paramases tek shumat e nenpozicioneve nuk përputhet me shumat totale përkatësisht ne pozicionet A1 deri ne A5; B1 deri B12, C1 deri C3 dhe E1 deri E6 ku shuma e nenpozicioneve sipas mbledhjes se numrave nga pamja vizuale ne PDF, mirëpo ne formulën e Excel te dokumenti (Përshkrimi i Çmimeve) i ngarkuar nga AK me formula te gatshme për llogaritje kane rrjedhur vlerat e lartcekur pasi që koeficienti i poentimit në tabelë kur shumëzohet me çmimin njësi të ofertuar nga ana jonë si OE nuk ka mundësi të dalë si numër me 2 shifra pas presjes çka në llogaritje matematikore e ka mbledhur vetë Excel pa asnjë gabim matematikorë. Gjithashtu çmimi final i peshuar nga ana jonë si OE është 0.55 siç shihet në foton më poshtë:

	GJITHESËJT TIPI - P:	0.55 €	9
	REKAPITULIM I PËRGJITHSHEM:	0.55 €	100

Gjithsesi, Çmimi i ofertuar nga ana jonë si OE në këtë rast është Çmimi njësi me TVSH i cili rrjedhimisht është i ofertuar edhe sipas kërkesës në dokumentin "Përshkrimi i Çmimeve" (Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës, oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjshme), Shih Foton e bashkangjitur:

Pretendimi 2:

OE i rekomanduar për kontrate ka një shkëputje te validitet te ofertës nga data 19.02.2024 deri me datën 27.02.2024 e cila kohe nuk është e mbuluar rrjedhimisht rekomandimi i këtij OE është ne kundërshtim me RRPP 001/2022.

Ligjërish AK nuk mund te kërkoj zgjatje te validitet te ofertës ne mënyrë retroaktive apo nuk mund te kërkojë te zgjasë afatin e validitet te ofertës ne një oferte te skaduar sipas LPP-se.

AK-ja gjate rivlerësimit te ofertave ka vepruar ne kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 59 te LPP-ne si dhe nenit 30.4 dhe 30.6 te RRPP 001/2022.

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

☐ Juve në ofertën e juaj, tek përshkrimi i çmimeve dhe paramasës shumat e nënpozicioneve nuk përputhen me shumën totale në pozicione si në vijim:

Shuma e nënpozicioneve A1 deri A5 të pozicionit A në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit A (shuma e nënpozicioneve është 0.16 euro ndërsa për pozicionin A është ofertuar me 0.17 euro).

Shuma e nënpozicioneve B1 deri B12 të pozicionit B në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit B (shuma e nënpozicioneve është 0.12 euro ndërsa për pozicionin B është ofertuar me 0.13 euro).

Shuma e nënpozicioneve C1 deri C3 të pozicionit C në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit C (shuma e nënpozicioneve është 0.03 euro ndërsa për pozicionin C është ofertuar me 0.04 euro).

Shuma e nënpozicioneve E1 deri E6 të pozicionit E në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit E (shuma e nënpozicioneve është 0.06 euro ndërsa për pozicionin E është ofertuar me 0.07 euro).

Fillimisht duhet sqaruar se të gjitha të gjeturat e komisionit vlerësues janë konfirmuar në tërësi si të sakta. Realisht edhe vet parashtruesi nuk i kundërshton të gjeturat si të tilla mirëpo pretendon se çmimi total i peshuar është në rregull. Duke marrë parasysh se shuma e nënpozicioneve në paramasë nuk përputhen me shumën e pozicioneve përkatëse, AK ka gjetur se oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme ndërsa pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimit se tenderuesi i rekomanduar nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës, ky pretendim është absolutisht i pabazuar pasi që i njëjti e ka vazhduar validitetin pa asnjë shkoputje sa herë që është kërkuar nga autoriteti kontraktues.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Infra Plus Sh.P.K." janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

- 4. Pretendimet e OE "Geo Group Sh.P.K." manifestohen duke kundërshtuar arsyet për shkak të cilave parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, duke pretenduar se "Arsyeja e AK-së për eliminim nuk përkon fare me realitetin dhe sipas asaj që shihet është veprim tendencioz dhe i qëllimshëm vetëm sa për të mos na shpallur neve si fitues".**

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

- Nuk keni plotësuar kushtin administrativ, konkretisht pjesën 1 te Formularit te Tenderit pika 3 nen kriteret 1 dhe 2, konform udhëzuesit për Prokurim Publik nr. 001/2023 pikës 10, ku shkruan si ne vijim:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
--	---	---------------------

- Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar as kërkesën e DT sipas të cilës do të duhej që të prezantoni jo më pak se 300,000.00 euro qarkullim bankar në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë ku së paku 51% të qarkullimit do të duhej të ishte dëshmuar nga lideri i GOE.
- Ju si GOE-ik nuk keni dorëzuar siç kërkohet me nenin 26 par. 26.1 nënpar. c) të RRPP, Marrëveshje mbi themelimin e grupit – konsorciumit; Autorizimin; Deklaratë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta të grupit – konsorciumit dhe Deklaratë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta të grupit – konsorciumit.:

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi ka dorëzuar si grup i operatorëve ekonomik së bashku me operatorin ekonomik "Illyrian Consulting Engineers Sh.P.K." Përmes nenit 26 par. 26.1 nënpar. c) të RRPP është përcaktuar se një tender mund të dorëzohet nga një Grup i Operatorëve Ekonomik me ç'rast së bashku me tenderin duhet të dorëzohet edhe: "Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit". Sipas dispozitës së sipërcituar respektivisht nenit 26 par. 26.1 nënpar. c) të RRPP përcaktohet se anëtarët e grupit të operatorëve ekonomik duhet të nënshkruajnë një deklaratë përmes të cilës "autorizohet partneri udhëheqës për të vepruar në emër të grupit". Pra operatori ekonomik që është udhëheqës (lider) do të autorizohet edhe për të vepruar në emër të grupit. Ndërsa te GOE parashtrues njëri anëtar është caktuar si bartës dhe tjetri si përfaqësues që nënkupton se është shkelur neni 26 par. 26.1 nënpar. c) i RRPP.

MARREVESHJE

Mbi Themelimin e Grupit – KONSORCIUMIT

E përpiluar në Tiranë, me datën 1 Qershor 2023 ndërmjet paleve:

1. **Shoqëria "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k.**, - person juridik shqiptar i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me numer identifikues K61814023M me adresë në Njesia Bashkiake nr. 5, Rrug Sami Frasheri, 50 m mbi shkollën Petro Nini Luarasi, Pallati Bjorn, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar ligjërish nga Administratori Olset Haxhiu.
2. **Shoqëria "GeO – Group" sh.p.k.**, - person juridik kosovar i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë me numer identifikues 810842353 me adresë në Arberia III Veranda C2, 10 Ob, D3 K.II Nr.14, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar ligjërish nga Kushtrim Krasniqi.

Me anën e kesaj marreveshje pale të kontraktuese deklarohen si vijon:

Kompanitë **"ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k.**, dhe **"GeO – Group" sh.p.k.**, me anë të kesaj marreveshje deklarohen themelimin e Grupit - Konsorciumit, me qëllim të ofertimit të përbashkët pranë Kuvendi i Komunes së Prishtinës projektin me titull: **"HARTIMI I PROJEKTEVE PER NDERTIM TE ULET"** me Numer Prokurimit: **616-23-4727-2-1-1**.

Pale të kontraktuese pajtohen që të bashkojnë potencialet dhe resurset e përbashkëta njerezore dhe materiale në funksion të themelimit të grupit – Konsorciumit për konkurrimin e përbashkët në tenderin e publikuar nga Kuvendi i Komunes së Prishtinës.

Pale të kontraktuese pajtohen që përfaqësimi pranë Kuvendi i Komunes së Prishtinës të bëhet sipas hierarkisë vijuese:

Shoqëria **"GeO-Group" sh.p.k.**, prezantohet si **Përfaqësuesi, Operatori Ekonomik Kontaktues** i këtij Grupi – Konsorciumi.

Shoqëria **"ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k.**, prezantohet si **Lider/Bartesi** i këtij grupi – konsorciumi.

Grupi i operatorëve ekonomik tenderues ka dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Marrëveshje mbi themelimin e grupit – konsorciumit;
2. Autorizim;
3. Deklaratë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta të grupit – konsorciumit; dhe
4. Deklaratë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta të grupit – konsorciumit.

Përmes nenit 26 par. 26.1 të RRPP dokumentet që kërkohen të dorëzohen në rastet kur tenderues është një grup i operatorëve ekonomik janë si vijon:

"26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet të:

- a. *Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;*
- b. *Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);*
- c. *Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprojt në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm".*

Nëse krahasohen dokumentet me të cilat ka ofertuar parashtruesi me dokumentet që janë kërkuar sipas nenit 26 par. 26.1 të RRPP, mund të vërehet se këto dokumente nuk përputhen as për nga lloji apo nga forma mirëpo as për nga përmbajtja e kërkuar. Pra nuk janë dorëzuar deklaratat e kërkuara sipas dispozitës së cituar më sipër. Për më tepër, në

deklaratën e operatorit ekonomik "Illyrian Consulting Engineers" thuhet se i njëjti e lëshon këtë deklaratë në cilësinë e liderit të grupit. Në anën tjetër është bashkangjitur edhe një deklaratë nga "Geo Group" ku thuhet se i njëjti e lëshon këtë deklaratë në cilësinë e partnerit të parë. Ngjashëm edhe në marrëveshjen për themelimin e GOE thuhet se "Illyrian Consulting Engineers" është lider/bartës ndërsa "Geo-Group" është përfaqësues i konsorciumit. Rrjedhimisht nuk është plotësuar si duhet pjesa I pika 3 nënkriteret 1 dhe 2 të RRPP të Dosjes së Tenderit në kuptim të nenit 26 të RRPP lidhur me nenin 71 të LPP. Prandaj duke marrë parasysh pikën 10 të UPP plotësimi i saktë i formularit të tenderit është kusht administrativ i cili në rast se nuk përmbushet, oferta refuzohet menjëherë si e papërgjegjshme pa nevojën që të kërkohen sqarime shtesë.

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor lidhur me qarkullimin e liderit të GOE në 3 vitet e fundit, është konstatuar po ashtu se e gjetura e komisionit vlerësues është konfirmuar si e saktë në tërësi ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Geo Group Sh.P.K." janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

5. **Pretendimet e OE "Studio Hapsira" janë se "Bazuar në sqarimin të ofertës tonë lidhur me çmimin jo-normalisht të ultë të datës 31.04.2024 : Kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar kemi shpjeguar Ekonominë e Procesit , listën e pagave të anagzhuar në këtë projekt , zgjidhjen teknike për inplemetin të kësaj kontrate , koston operative , koston e shpenzimeve në printime si dhe taksat ,tatimet dhe fitimet e përcaktuar me ligjet në fuqi të Kosovës. GOE rekomanduar për kontratë VISION PROJEKT&SEED CONSULTING ME VLERË TË PESHUAR 1.59 Euro ,bazuar në rregullat për tenderat jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për çmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II,dhe III" .**

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

- Autoriteti kontraktues ju ka dërguar letrën standarde B41 kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët. Pas analizimit të sqarimeve tuaja, Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se sqarimet e dërguara nuk janë bindëse sepse çmimet për projektim janë abnormalisht të ulëta. Çmimi abnormalisht i ulët është kalkuluar mbështetur në rregulloren për Prokurim Publik 001/2022, neni 41**

Sa i përket pretendimit se parashtruesi nuk ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët duke kundërshtuar konstatimin e komisionit vlerësues, fillimisht duhet cekur se nga 8 ofertat e dorëzuara, komisioni vlerësues ka gjetur se ekziston vetëm një ofertë me çmim më të lirë sesa parashtruesi me 0.08 euro ndërsa çmimi i parashtruesit është i dyti më lirë me 0.23 euro. Të gjitha çmimet tjera janë rreth 0.40 euro e më lartë (pra janë 2 fish apo 3 fish më të shtrenjta sesa çmimi i parashtruesit). Për këtë arsye komisioni vlerësues ka kërkuar sqarim shtesë nga parashtruesi i cili ka kthyer përgjigje me datë 31.01.2024. Sqarimet e tilla janë analizuar me kujdes nga komisioni vlerësues në kuptim të nenit

41.8 dhe 41.9 të RRPP ku përcaktohet se “41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- a. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

- a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet” .

Me këtë rast komisioni ka konfirmuar pa asnjë mëdyshje se çmimi i ofertuar është jonormalisht i ulët pasi që në sqarim fare nuk janë argumentuar:

- ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.
- elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet” .

Sa i përket pretendimit ankimor se edhe oferta e tenderuesit të rekomanduar është jonormalisht e ulët, së pari duhet sqaruar se ky pretendim është kundërthënës me pretendimin paraprak sepse oferta e tenderuesit të rekomanduar është 1,59 euro ndërsa oferta e parashtruesit është 0.23 euro. Pra nuk ka kuptim të pretendohet se çmimi prej 0.23 euro nuk është jonormalisht i ulët ndërsa çmimi prej 1.59 është i tillë. Sidoqoftë, AK ka analizuar me kujdes ofertën e tenderuesit të rekomanduar dhe ka gjetur se oferta në fjalë është e vetmja e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Përmes nenit 4.3 të RRPP përcaktohet se “Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”. Në rastin konkret nuk janë përmbushur këto kritere dhe nuk ekziston asnjë dilemë për çmim jonormalisht të ulët nga tenderuesi i rekomanduar.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE “Studio Hapsira Sh.P.K.” janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se asnjë nga parashtruesit nuk kanë paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tyre. Prandaj kërkesat për rishqyrtim të parashtruesve janë refuzuar si e pabazuara në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.12.2024

Visar SHEHU


Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.